

SISTEMI FINANCIAR NË SHQIPËRI

---

**Fatos Ibrahimi,**  
**Zëvendësguvernator i Parë i Bankës së Shqipërisë**  
**Drini Salko**  
**Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së**  
**Shqipërisë**

## **1. HYRJE**

Ndryshimet e thella politike në Shqipëri në fillimet e viteve '90 e bënë të domosdoshme kryerjen e reformës në ekonominë shqiptare që do të bënte të mundur transformimin nga sistemi i ekonomisë së planifikuar drejt sistemit të ekonomisë së tregut.

Një element mjaft i rëndësishëm në fushën e reformave strukturore për të gjitha vendet që u futën në rrugën e ekonomisë së tregut ishte edhe reforma në fushën e sistemit financiar e atij bankar.

Eficiencia dhe shpejtësia e reformimit të sistemit financiar ka një rëndësi mjaft të madhe për procesin e transformimit, pasi eficienca e shpejtësia e reformës në këtë sektor ka një influencë vendimtare në shpejtësinë e procesit të transformimit të sektorëve të tjerë të ekonomisë.

Sistemi financiar, i konceptuar si bashkësi e **institucioneve**, e **tregjeve** dhe e **instrumenteve financiare**, ka patur zhvillime relativisht pozitive gjatë 10 viteve të fundit duke u përballuar me mjaft sfida e vështirësi në rrugën e perfeksionimit e të konsolidimit të tij.

Nuk mjaftuan kushtet e disfavorshme makroekonomike, financiare dhe prapambetja në zhvillimin e institucioneve financiare e bankare në të cilat kjo reformë filloi, por ajo u përball edhe me mjaft vështirësi të tjera, të cilat arritën kulmin me krizën e piramidave, që shërbeu si një shkëndijë që destabilizoi gjithë vendin dhe e futi ekonominë shqiptare në një kolaps të plotë. Në këtë kontekst, vazhdimi më i plotë dhe më i shpejtë i reformimit të sistemit financiar u konsiderua nevojë emergjente e ekonomisë.

Zhvillimet e viteve të mëvonshme u karakterizuan nga vazhdimësia e reformave në sistemin financiar dhe në atë bankar. Reformat e ndërmarra dhe ato që po zbatohen kanë synuar rritjen e efektshmërisë të sistemit nëpërmjet realizimit fillimisht të ristrukturimit dhe privatizimit të institucioneve financiare.

Si rrjedhim, tashmë në Shqipëri operojnë 13 banka universale. Sipas pronësisë së kapitalit, Banka e Kursimeve është e vetmja bankë me kapital shtetëror, ndërsa të tjerat janë me kapital të përbashkët (2) dhe me kapital privat (10).

Zhvillime ka patur edhe në operimin e institucioneve të tjera financiare jobankare. Në tregun shqiptar operojnë katër shoqëri private sigurimesh. Edhe vetë Instituti i Sigurimeve (INSIG), si institucioni kryesor në këtë fushë, synohet që të privatizohet. Gjithashtu, me përmirësimet e bazës ligjore, është e hapur mundësia e operimit të ndërmjetësve të tjerë financiarë si dhe e instituteve private të pensioneve.

Megjithëse jo i zhvilluar, funksionon tregu i parasë, ndërsa tregu i kapitalit është ende në fazën embrionale. Premisat e zhvillimit të këtyre tregjeve bazohen në përpjekjet që tashmë kanë filluar të bëhen, për shtimin e operatorëve të tregut dhe të instrumenteve që tregtohen në të. Bazë në zhvillimin e tregut të kapitalit është edhe procesi i privatizimit të kompanive shtetërore, që po njih një ritëm më të mirë gjatë dy viteve të fundit.

Tashmë, kur po i afrohem fundit të vitit 2001, ne mund të themi se reformat e ndërmarra në sistemin financiar, në përgjithësi, dhe sidomos ato në sistemin bankar janë përsheptuar duke ndikuar pozitivisht në stabilizimin makroekonomik dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Për vetë trashëgiminë dhe stadin e arritur të zhvillimit të sistemit financiar, institucionet financiare dhe para së gjithash ato bankare zënë peshën më të rëndësishme në të. Peshën kryesore të sistemit financiar e tregon dhe tabela e mëposhtme në të cilën jepet pesha e aktiveve të institucioneve financiare ndaj aktiveve gjithsej të tyre.

**Tabelë nr.1. Pesha specifike e aktiveve të institucioneve financiare (më 30.09.2001).**

Institucionet	Madhësia absolute e aktiveve	Në %
Sistemi bankar	301.0	95.0
Fondi i pensionit	7.60	2.4
Institucionet e sigurimit	8.0	2.6
	316.6	100.0

Zhvillimet e dy komponentëve të tjerë të sistemit financiar përbëjnë një nga sfidat e zhvillimit afatmesëm të ekonomisë shqiptare. Prandaj, dhe në këtë material, do të shtjellojmë më tepër probleme të sistemit bankar.

## **2. POLITIKA E STABILIZIMIT NË FILLIMET E TRANZICIONIT**

Shqipëria hyri në rrugën e transformimit të ekonomisë nga një ekonomi e planifikuar e tipit lindor në ekonomi tregu të tipit perëndimor duke zbatuar të njëjtën skemë që ndoqën edhe vendet e tjera të Lindjes. Kjo skemë synonte fillimisht stabilizimin e ekonomisë nëpërmjet politikave monetare dhe buxhetore dhe, njëkohësisht me këto masa, të zbatoheshin edhe masat që synonin kryerjen e reformave strukturore.

Politika e stabilizimit dhe reformat strukturore përbëjnë një bashkësi të pandarë. Në paketën e masave të hartuara për

transformimin e ekonomisë së Shqipërisë në ekonomi tregu është mbajtur parasysh edhe fakti që, gjatë 45 vjetëve të regjimit komunist, Shqipëria ka qenë vendi që adoptoi politikat më ekstreme të dominimit të shtetit në ekonomi lidhur me të drejtat mbi pronën dhe ushtrimin e planifikimit të centralizuar. Politikat financiare i përgjigjeshin në mënyrë pasive realizimit të detyrave të planit, i cili ishte ligj, dhe një sistem kompleks i këmbimit dhe i tregtisë synonte ta izolonte ekonominë nga ndryshimet e çmimeve në tregun botëror.

Reformat e kufizuara në vitet '85-90, jo vetëm acaruan vështirësitë ekonomike, por, për herë të parë, ballafaquan Shqipërinë me tregues të panjohur më parë. Në vitin 1990, u shfaq deficit buxhetor, i cili zinte 15 për qind të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) të kësaj periudhe.

Duke filluar nga viti 1990, krizat u shpalosën me shpejtësi duke përkuar me shkatërrimin e regjimit të vjetër dhe me kalimin në sistemin e ekonomisë së tregut. Ekonomia u zhyt në kolaps, inflacioni u karakterizua nga ritme galopante dhe borxhi i jashtëm u thellua më tej. Sektori që u godit më shumë ishte industria, prodhimi i së cilës ra mbi 40 për qind gjatë vitit 1991, ndërkohë që mjaft degë të saj u mbyllën plotësisht. Si rezultat i prishjes spontane të ish-kooperativave bujqësore dhe i shkatërrimit të sistemit të shpërndarjes, prodhimi bujqësor ra në mënyrë të ndjeshme. Me rënien drastike të prodhimit, deficit buxhetor u thellua (në rreth 45-50 për qind të PBB-së gjatë vitit 1991) për shkak të shkatërrimit të bazës së të ardhurave të buxhetit, që siguroheshin nga derdhjet në buxhet prej ndërmarrjeve shtetërore. Deficit buxhetor u mbulua nëpërmjet financimit monetar gjë që çoi në norma inflacioni deri në 10-15 për qind në muaj, në dollarizimin e ekonomisë dhe në shterimin e rezervave valutore.

Në këto kushte, Qeveria e dalë nga zgjedhjet e marsit të vitit 1992 përpunoi programin ekonomik që synonte transformimin e ekonomisë në një ekonomi që do të funksionojë në bazën e ligjeve të ekonomisë së tregut.

Paketa e masave të përpiluara përmbante elementet e mëposhtme :

a) Stabilizimi makroekonomik (pakësimi i deficitit buxhetor dhe i borxhit publik, frenimi i inflacionit). Në këtë kuadër, përfshihej dhe reformimi i sistemit financiar si domosdoshmëri për arritjen e këtij objekti.

b) Liberalizimi i çmimeve dhe heqja e subvencioneve.

c) Liberalizimi i aktivitetit ekonomik nëpërmjet eliminimit të planifikimit qendror: krijimi i kushteve të funksionimit të tregut të lirë, nëpërmjet krijimit të institucioneve të reja (bankat tregtare të pavarura nga banka qendrore, shoqëritë e sigurimit dhe bursa e letrave me vlerë).

d) Zëvendësimi i pronës së shtetit nëpërmjet formave të ndryshme të pronës joshtetërore (prona private personale, shoqërore, kooperativiste duke përfshirë edhe pronën e agjentëve ekonomikë të huaj, heqja e monopolit të vjetër shtetëror, inkurajimi i krijimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme private).

e) Hapja e ekonomisë me jashtë, heqja e monopolit shtetëror të tregtisë së jashtme, liberalizimi i eksport-importit, konvertibiliteti i monedhës.

## **2.1 REFORMA NË INSTITUCIONET FINANCIARE E BANKARE**

Transformimi dhe reformimi i sistemit financiar shqiptar u bazua kryesisht vetëm në reformimin e komponentit të parë të tij, atë të institucioneve financiare që operonin në vend, pasi të dy komponentët e tjerë ishin pothuajse inekzistentë gjatë gjithë periudhës së ekonomisë socialiste.

Reforma në Shqipëri, që filloi me objektivat për stabilizimin makroekonomik, u shoqërua edhe me masat e karakterit strukturor që synonin privatizimin e ekonomisë, krijimin e institucioneve financiare të ekonomisë së tregut. Pra, një element i rëndësishëm në grupin e reformave strukturale institucionale janë edhe reformat në fushën e institucioneve monetare dhe financiare, të cilat krijojnë kuadrin e nevojshëm për kryerjen dhe shpejtimin e privatizimit si dhe krijimi i tregjeve financiare krahas me tregjet reale të të mirave dhe të shërbimeve.

Por, përpara se analiza të përfshijë periudhën kur filluan transformimet në sistemin tonë bankar, le të bëjmë një historik të shkurtër të lindjes së sistemit bankar në Shqipëri deri në vitin 1990.

### **2.1.1. Pak histori mbi lindjen e sistemit bankar në Shqipëri**

Duhet thënë se në Shqipëri për shkak të prapambetjes në nivelin e zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste në prodhim, trashëgimia në fushën e institucioneve të ekonomisë së tregut ka qenë e varfër dhe krijimi i tyre është bërë më vonë se shtetet e tjera europiane dhe ballkanike.

Kështu, sistemi bankar në Shqipëri zë fill me marrëveshjen e 25 marsit 1925 midis Qeverisë së Zogut dhe një grupi financiar italian që shënon dhe krijimin e Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Në Shqipëri u zbatua një sistem monetar me mbulesë relativisht të qëndrueshme metali, të barabartë me një të tretën e bankënotave në qarkullim, një sistem që kishte ngjashmëri me sistemin ardevizë. Ky lloj sistemi u vendos duke mbajtur parasysh edhe psikologjinë e popullit shqiptar, i cili, i mësuar të përdorte si para vetëm arin dhe argjendin, e kishte të vështirë të pranonte, në këmbim të tyre, bankënotat e emetuara nga banka. Ndaj ky sistem kishte si qëllim të rriste besimin e publikut për të depozituar paratë në bankë.

Pas çlirimit të vendit, puna për ngritjen e sistemit tonë monetar filloi me themelimin e Bankës së Shtetit Shqiptar, e cila e filloi veprimtarinë e saj më 22 janar 1945 dhe e përfundoi me reformën monetare në vitin 1946. Gjithë masat e tjera, të marra pas vitit 1946, janë diktuar nga nevoja e përsosjes së sistemit ose për arsye të faktorëve të jashtëm.

Reforma monetare e vitit 1946 caktoi kurse të tjera këmbimi, të bazuara në fuqinë blerëse të kartëmonedhës së re, në bazë të çmimit të arit dhe të raporteve të tij me mallrat e tjerë.

Gjatë vitit 1946 e më pas u plotësuan funksionet e bankës së shtetit dhe u kalua në mënyrë të shkallëzuar në organizimin dhe në drejtimin e planifikuar të qarkullimit të monedhës. Banka e Shtetit u ngarkua me funksionet e një banke qendrore dhe të bankave të nivelit të dytë.

Deri në vitin 1970, në sistemin bankar në Shqipëri funksiononte Banka e Shtetit Shqiptar që kishte funksionet e një banke qendrore dhe të bankave të nivelit të dytë. Ajo përmbushte funksionet e emisionit të monedhës, të zbatimit të politikës monetare, të zbatimit të buxhetit dhe të marrëdhënieve me jashtë si dhe u shërbente ndërmarrjeve shtetërore nëpërmjet mbajtjes së llogarive dhe dhënies së kredive. Krahas Bankës së Shtetit Shqiptar, që nga viti 1949 u krijua Drejtoria e Arkave të Kursimit, e cila u ngarkua me grumbullimin e mjeteve të lira monetare të popullit. Në vitin 1953, arkave të kursimit iu ngarkua edhe kryerja e aktivitetit të sigurimeve shtetërore të pasurisë duke krijuar Institutin e Arkave të Kursimeve dhe Sigurimeve. Veprimtarinë e vet, ky institut, e zhvilloi deri më 31.07.1991 kur me ligjin nr. 7505 u krijua Banka e Kursimeve, mbi bazën e ndarjes së këtij instituti. Banka e

Kursimeve e filloi veprimtarinë saj si bankë në tremujorin e fundit të vitit 1991.

Nevojat e kreditimit të bujqësisë kushtëzuan krijimin, në dhjetor të vitit 1969, të Bankës Bujqësore, e cila e filloi veprimtarinë e saj në janar të vitit 1970. Në funksionet që kishte kjo bankë, vend të rëndësishëm zinte kreditimi afatshkurtër i ndërmarrjeve bujqësore, pasi nevojat për investime plotësoheshin nëpërmjet financimit buxhetor, si dhe kreditimi afatshkurtër dhe afatgjatë i kooperativave bujqësore. Por, duhet thënë se kjo bankë nuk funksiononte e ndarë më vete plotësisht nga Banka e Shtetit, ajo ishte si shtojcë e saj. Plani i kreditit i kësaj banke ishte rreptësisht i kontrolluar dhe përfshihej në planin e kreditit të shtetit. Po kështu, shërbimi i arkëtimit ishte i përbashkët dhe kryhej nga Banka e Shtetit. Një gjendje e tillë varësie vazhdoi deri në maj të vitit 1990, kur me ligjin nr. 7378 u miratua ligji "Për Bankën Bujqësore" mbi bazën e të cilit u nda veprimtaria e Bankës Bujqësore.

Kjo gjendje e sistemit bankar, që përbëhej nga dy banka dhe Instituti i Arkave të Kursimit, vazhdoi deri në vitin 1990 kur, si rezultat i ndryshimeve në Lindje, ndryshime që filluan me Perestrojkën në Rusi që në vitin 1985 dhe i presionit të brendshëm, që arriti kulmin me lëvizjen studentore në Shqipëri, në dhjetor të vitit 1990, u lejua pluralizmi politik, i cili i hapi rrugën transformimit të ekonomisë së centralizuar në ekonomi tregu.

### **2.1.2. Kushtet në të cilat filloi transformimi i sistemit bankar**

Transformimi i sistemit bankar në Shqipëri ashtu si edhe në vendet e tjera të Lindjes si Hungari, Poloni, Çekosllovakia, Bullgari dhe Rumania filloi mbi bazën e sistemit bankar socialist. Por, në dallim nga vendet e tjera, duhet thënë se në Shqipëri asnjëherë nuk janë ndërmarrë masa për reformimin e sistemit socialist të ekonomisë. Në vendet e tjera ish-socialiste janë bërë, herë pas here, përpjekje për reformimin e sistemit socialist, por ato nuk synonin asnjëherë transformimin rrënjësor të sistemit në ekonomi tregu të bazuar tek prona private, por vetëm rregullime të pjesshme të tij. Fillimisht, bëhej fjalë për rritjen e saktësisë dhe të efikasitetit të procesit të planifikimit (duke forcuar strukturat institucionale, duke përcaktuar detyra sa më të qarta dhe duke përsosur levat e kontrollit administrativ). Megjithatë, u pa shpejt se këto reforma të pjesshme nuk mundën ta lehtësojnë aspak tensionin në rritje të ekonomisë, gjë që dukej në mungesat e theksuara për mallra të konsumit të gjerë, në prodhimet me cilësi të dobët si dhe në progresin shumë të ulët teknik.

Kështu, deri në vitin 1989 në fushën e sistemit bankar, nuk ishte bërë asnjë ndryshim. Sistemi bankar shqiptar karakterizohej nga monobanka, që kryente rolin e bankës qendrore dhe tregtare. Si bankë qendrore ajo ishte përgjegjëse për emisionin e monedhës, për kontrollin mbi politikën monetare dhe plotësonte nevojat e ndërmarrjeve nëpërmjet shpërndarjes së kredisë dhe shërbimit të arkëtimit, që u kryente atyre si mbajtëse e llogarive. Funksiononte, gjithashtu, një arkë kursimi që merrej me administrimin e depozitave të popullatës, të cilën nuk mund ta quajë bankë, pasi ajo vetëm pranonte depozita dhe nuk jepte kredi për popullsinë. Ajo kryente edhe një funksion tjetër, atë të sigurimit të pasurisë, ku sigurohej kryesisht pasuria kooperativiste. Veç këtyre dy institucioneve financiare funksiononte edhe një bankë e marrëdhënieve me jashtë, që mbante kryesisht llogaritë e ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme dhe trajtonte aktivet dhe pasivet me jashtë. Një bankë e tillë në Shqipëri u krijua me dekretin nr. 7439, datë 01.12.1990.

## **2.2 FILLESAT E REFORMIMIT TË SISTEMIT FINANCIAR**

Me kalimin në ekonominë e tregut, rëndësi të madhe mori transformimi i sistemit tonë financiar. Reformimi i sistemit financiar merr një rëndësi të madhe në stabilitetin makroekonomik. Të gjitha vendet, që kanë pasur si objektiv këtë transformim, kanë synuar krijimin e sistemit bankar me dy nivele, rritjen e shkallës së autonomisë së bankës qendrore, rritjen e konkurrencës në gjirin e sistemit bankar, inkurajimin e zhvillimit të tregut monetar dhe të atij financiar, racionalizimin e sistemit të pagesave, vendosjen e një sistemi efikas të kontrollit të bankave si dhe ristrukturimin e sistemit bankar dhe privatizimin e tij.

Etapa e parë e rëndësishme në reformën e sistemit financiar të vendeve me ekonomi të planifikuar fillon me kalimin nga sistemi monobankar, në një sistem me dy nivele në të cilin banka e shtetit merr funksionet tradicionale të bankës qendrore (që kryen funksionin e emisionit, zbaton politikën monetare, ndërhyr në fushën e këmbimeve me jashtë etj.) dhe bankat tregtare të krijuara rishtaz ngarkohen me transaksionet lidhur me pranimin e depozitave dhe dhënien e kredive. Tabela 1 pasqyron periudhën kur hyri në fuqi ligji për sistemin e ri bankar në gjashtë shtete duke përfshirë Hungarinë, Poloninë, Çekoslovakinë, Bullgarinë, Rumaninë dhe Shqipërinë. Siç shihet nga tabela, në të gjitha vendet, me përjashtim të Rumanisë dhe të Shqipërisë, ligji për sistemin e ri bankar është miratuar përpara se në këto vende të

lejohej pluralizmi politik. Veç kësaj, shihet që Hungaria dhe Polonia kanë qenë më përpara me reformat në këtë sektor duke miratuar ligjin e ri përkatësisht në vitet 1987 dhe 1989. Një veçori tjetër, për këto dy shtete, ishte ekzistenca e bankave private, përkatësisht 2 dhe 5 banka, përpara se të miratohej ligji i ri - "Për sistemin bankar".

Tek ne, ligji për Bankën e Shqipërisë u miratua në 22 prill 1992 duke shfuqizuar ligjin e mëparshëm "Për Bankën e Shtetit Shqiptar". Me anën e këtij ligji Bankës Qendrore iu kaluan shumë kompetenca që më parë i kishte Qeveria si: përcaktimi i vëllimit të kredisë, emisioni i kartëmonedhës, interesi bankar, format e pagesave etj.. Po kështu, varësia e Bankës Qendrore kaloi nga Qeveria tek Parlamenti.

**Tabelë nr. 2. Gjendja e sistemit bankar para transformimit <sup>26</sup>.**

	Hungari	Poloni	Çekl	Bullgaria	Rumani	Shqipëri
Data e fillimit të pluralizmit politik	1989	Prill 1989	Nën. 1989	Nën. 1989	Dhjet 1989	Dhjet 1990
Numri i bankave tregtare shtetërore	4	9	2	59	4	3
Numri i bankave tregtare të huaja	2	5	0	0	2	0
Numri i bankave të specializuara	10	1	1	8	2	0
Numri i bankave të specializuara në mesatare me jashtë	1	3	2	1	1	1
Numri i bankave të kursimit	1	1	2	1	1	1

Ligji i vitit 1992 për Bankën e Shqipërisë krijoi mundësinë për ngritjen e një institucioni sipas modelit të vendeve perëndimore me shkallë relativisht të lartë pavarësie, e cila është thelluar me dy ligjet e mëvonshme të viteve 1996 dhe 1998.

Ligji përcaktoi dhe ndryshoi varësinë e Bankës së Shqipërisë nga Qeveria tek Kuvendi, përcaktoi objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë " ruajtja e stabilitetit të brendshëm dhe të jashtëm të monedhës " dhe krahas problemeve të organizimit të brendshëm lidhur me strukturat drejtuese si këshilli i mbikëqyrjes, këshilli drejtues dhe Guvernatori, ligji përcaktoi qartë detyrat e Bankës së Shqipërisë në fushën e politikës monetare dhe të mbikëqyrjes bankare.

<sup>26</sup> Alfredo Throne: Eastern Europes experience with banking reform.

Rëndësi të veçantë i dha marrëdhëniet e bankës qendrore me qeverinë, lidhur me financimin e deficitit buxhetor si një fenomen i ri dhe me të cilin do të ballafaqohej në vazhdimësi vendi ynë.

Miratimi i dy ligjeve për Bankën e Shqipërisë dhe për sistemin bankar, shënoi krijimin e sistemit të ri bankar në Shqipëri.

Kuadri ligjor, në këtë periudhë, bëri të mundur krijimin e Bankës së Shqipërisë (BSH) me atributet e një banke qendrore, dhe të tre bankave me kapital shtetëror; Bankës Kombëtare Tregtare (BKT), Bankës së Kursimeve (BK) dhe Bankës Bujqësore dhe të Zhvillimit që shpejt ndërroi emrin në Banka Tregtare Agrare (BTA).

### **3. REFORMA E SISTEMIT BANKAR DHE PROBLEME TË ZHVILLIMIT TË TIJ**

#### **3.1. BAZA LIGJORE DHE KUADRI RREGULLATIV**

Kuadri ligjor dhe rregullativ bankar ka pësuar ndryshime të vazhdueshme gjatë 10 viteve të fundit si pasojë, jo vetëm e nevojës së perfeksionimit, por edhe e zhvillimit të dukurive negative në këtë sektor.

Në prill dhe maj të vitit 1992, u hodhën bazat ligjore për formulimin e politikave monetare, për krijimin e bankave tregtare dhe për rregullimin e veprimtarisë së tyre. Këto baza u hodhën me miratimin e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” si autoriteti më i lartë monetar i vendit i autorizuar për formulimin e politikave monetare dhe për rregullimin e sistemit bankar, si dhe me miratimin e ligjit “Për sistemin bankar në Shqipëri”, ku përcaktohej mënyra e organizimit dhe e funksionimit të bankave tregtare. **Në përputhje me këto ligje, u formua një sistem bankar dynivelor në të cilin përfshiheshin: Banka e Shqipërisë (BSH) si bankë qendrore dhe bankat tregtare që mbikëqyreshin prej saj.**

Këto dy ligje bazë, pësuan ndryshime të konsiderueshme në vitin 1996 duke reflektuar ndryshimet e ndodhura deri në këtë periudhë.

Kriza financiare e vitit 1997, e shkaktuar nga falimentimi i skemave piramidale, dëshmoi se edhe në kuadrin ligjor bankar kishte mangësi të theksuara, që lejuan lulëzimin e këtyre skemave. Ishte kjo arsyeja kryesore që gjatë fundit të viteve 1997 dhe 1998 të dy ligjet (ligji “Për Bankën e Shqipërisë” dhe ai “Për sistemin bankar”) të pësonin ndryshime të theksuara që synuan si rritjen e pavarësisë të Bankës së Shqipërisë si autoritet monetar dhe

mbikëqyrës, ashtu dhe forcimin e vetë sistemit bankar nëpërmjet rregullimeve dhe forcimit të mekanizmave të tregut.

Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” synon të sigurojë pavarësinë institucionale, reale dhe formale të bankës qendrore në funksion të objektivit të saj kryesor, ndërsa ligji “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” synon ndërtimin e një sistemi të plotë rregullator e mbikëqyrës të bankave. Kuadri rregullator i hartuar, është duke u bazuar gjithnjë e më shumë në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të huave, të krijimit të fondeve rezervë, të normave të mjaftueshmërisë së kapitalit, të likuiditetit, të pozicionit të këmbimeve valutore etj..

Krahas përmirësimit ligjor, Banka e Shqipërisë gjatë viteve të fundit ka përmirësuar ndjeshëm kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës të bankave të nivelit të dytë duke forcuar rregullat e licencimit dhe duke qartësuar përcaktimet e normave standarde ndërkombëtare mbi mjaft nga treguesit e veprimtarisë bankare.

**Mbikëqyrjes dhe inspektimit të Bankës së Shqipërisë i nënshtrohen, pa dallim, bankat shqiptare apo degët e bankave të huaja, bankat shtetërore apo private si dhe çdo subjekt tjetër financiar, që licencohet nga Banka e Shqipërisë.**

Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ në fushën bankare është bërë në përputhje me strategjinë e Bankës së Shqipërisë për një mbikëqyrje efektive. Objektivi strategjik i kësaj mbikëqyrjeje është krijimi i një sistemi bankar të sigurt dhe me gjendje të shëndoshë financiare . Realizimi i këtij objektivi strategjik është një proces dinamik dhe kërkon përmbushjen e një sërë objektivave afatshkurtër dhe afatmesëm si:

- konsolidimi i mëtejshëm i kuadrit rregullator e mbikëqyrës që të konvergojë me standardet ndërkombëtare të Komitetit të Bazelit dhe me direktivat e Bashkimit European për mbikëqyrjen bankare;

- sigurimi i respektimit dhe i zbatimit rigoroz të kuadrit ligjor dhe rregullator;

- kufizimi i ndërmarrjes, nga ana e bankave, të rreziqeve të tepërta, të cilat kërcënojnë depozitat e klientëve.

Arritja e këtyre objektivave po sigurohet nëpërmjet:

- a. mbikëqyrjes së procesit të hyrjes së bankave të reja (licencimi);

- b. rregullimit të bankave të nivelit të dytë dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të respektimit të rregullave;

c. mbikëqyrjes së ecurisë financiare të bankës (analiza e bankave dhe e sistemit bankar);

d. mbikëqyrjes së procesit të trajtimit të bankave me probleme (nga marrja e veprimeve korrektuese deri tek revokimi i licencës).

### **3.2 ZHVILLIMET NË SISTEMIN BANKAR**

Ekonomia shqiptare gjatë kësaj periudhe të vitit 2001, njohu gjallërim të mëtejshëm. Kjo evidentohet kryesisht në zhvillimet pozitive të tregut të punës dhe të rritjes së aktivitetit tregtar. Të dhënat më të fundit të vitit 2001 vërtetuan konsolidimin e ekuilibrave të vendosur në periudhat e mëparshme.

Rritja ekonomike në këtë periudhë i dedikohet kryesisht gjallërimit të aktivitetit të sektorit privat, i cili vërehet në rritjen e nivelit të kreditimit të tij, në importin e makinerive dhe të pajisjeve, në rritjen e të ardhurave fiskale nga ky sektor si dhe në drejtime të tjera, në një kohë që ndikimi i sektorit shtetëror në tërësinë e aktivitetit ekonomik po bëhet gjithnjë e më dytësor.

Inflacioni vjetor, në fund të shtatorit rezultoi 3.53 për qind. Megjithëse në disa muaj të kësaj periudhe ai ka shënuar norma mujore negative, normat vjetore të tij kanë qenë pozitive, por brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë edhe në këtë periudhë, me objektiv kryesor - stabilitetin e çmimeve-, u zbatua fillimisht si një politikë liberale (zbatim i vazhdimësi i normave të ulëta të interesit) dhe më pas neutrale (përderisa nuk tenton në rritjen e normave të interesit). Krahas ankandëve të repove, si një mjet për uljen e kostos së ndërmjetësimit bankar, vazhdoi të zbatohet në këtë gjashtëmujor edhe remunerimi i rezervës së detyrueshme, megjithëse nuk arriti rezultatin e pritshëm (pasi çmimi i kredidhënies vazhdon të jetë ende i lartë).

Situata makroekonomike stabël në vend në këtë periudhë dha ndikimin e vet edhe në ecurinë e sistemit bankar shqiptar. Sistemi bankar shqiptar vazhdon të mbetet segmenti më i madh dhe më i zhvilluar i tregut financiar në vend. Ai përbëhet nga 13 banka, ndër të cilat 1 bankë me kapital shtetëror (banka më e madhe e sistemit), 2 banka me kapital të përbashkët dhe 10 banka me kapital privat (përfshirë 3 degë të bankave të huaja).

Sistemi bankar shqiptar është i dominuar nga grupi i bankave shtetërore dhe më konkretisht nga Banka e Kursimeve. Karakteristikë është që ky përqendrim është i lartë në lidhje me aktivitetin gjithsej, në shtrirjen e rrjetit, në aktivitetin depozitues dhe në atë të investimit në bonot e thesarit. Përqendrimi i aktivitetit bankar është më tepër pasojë e historisë së krijimit të këtij sistemi sesa rrjedhojë e sjelljeve të vetë bankës dominuese për të penguar hyrjen e bankave të reja dhe zgjerimin e aktivitetit të tyre. Nga ana tjetër, numri i bankave të reja në treg është rritur dhe për pasojë ato po fitojnë gjithnjë e më tepër peshë në tregun bankar shqiptar.

Kështu, tendenca e shfaqur në treg, sidomos pas vitit 1997, është reduktimi i vazhdueshëm i raporteve të përqendrimit, domethënë i dominimit të tregut nga Banka e Kursimeve. Më e theksuar kjo tendencë është bërë gjatë vitit 1999 dhe në vazhdim. Për më tepër, pritet që në të ardhmen kjo tendencë të vazhdojë akoma më e fortë. Arsyet e mundshme për këtë ndryshim janë:

- shtimi i numrit të bankave që veprojnë në Shqipëri;
- aktiviteti më intensiv i bankave private;
- privatizimi i Bankës së Kursimeve (procesi i përgatitjes për privatizim do të shoqërohet me një tkurrje dhe ngrirje të aktivitetit të saj);
- veprimet e Bankës së Shqipërisë në favor të nxitjes së konkurrencës.

### **3.2.1. Privatizimi i bankave me kapital shtetëror**

Reforma e sistemit bankar është përshkruar nga mendimi se bankat do të përbënin institucionet më të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë në të ardhmen. **Motoja e bankave do të ishte trinomi: mbështetja dhe zhvillimi i ekonomisë shqiptare; mbështetja dhe respektimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë; mbijetesë dhe progresi i tyre.** Bankat arritën të kombinonin, gjatë kësaj periudhe, objektivat e tyre për mbijetesë në kushtet e ekonomisë së tregut me respektimin e normave të mbikëqyrjes, të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë. Duke marrë në konsideratë peshën që kanë bankat shtetërore në tregun bankar, kuptohet se rritja e eficiencës së tyre përbënte prioritetin e këtij reformimi. Natyrisht, që privatizimi i tyre përbën dhe rrugën kryesore për arritjen e këtij objekti. Vënia e bankës në duart e privatëve, të cilët janë përgjegjës për çdo humbje, e përfundon kanalizimin e fondeve të Qeverisë për të mbuluar humbjet e bankave. Gjithashtu, privatizimi i tyre do të çojë në një kontroll më

të mirë të kostos për shkak të përmirësimit të shpejtë të drejtimit e të futjes së kapitalit dhe teknologjisë së re.

Procesi i privatizimit të bankave shtetërore, i filluar në vitin 1995 me miratimin e ligjit *“Për transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe lejimin e privatizimit të tyre”* u pasua më vonë me mjaft akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Mungesa e eficiencës së këtyre bankave, sidomos në treguesin e kthyeshmërisë së kredisë, tregoi se hapat fillestarë të ristrukturimit qenë të pamjaftueshëm. Fillimisht u likuidua Banka Tregtare Agrare, pjesë të aktivitetit të së cilës u transferuan në bankat e tjera shtetërore, ndërsa huatë e këqija u transferuan tek Agjencia e Ristrukturimit të Kredive. Ky proces, jo vetëm nuk solli ndonjë shqetësim të depozituesit, por ndikoi në shkurtimin dhe përshtetimin e procedurave për dy bankat e tjera të cilat, mbështetur në bazën ligjore, filluan të përgatiten për privatizim.

**Formula e përdorur në privatizimin e Bankës Kombëtare Tregtare dhe të Bankës së Kursimeve synon, krahas rritjes së eficiencës së bankave edhe tërheqjen e investitorëve strategjikë, gjë që shpërndan më gjerë pronësinë mbi kapitalin dhe thithjen e kapitalit të huaj.** Është kjo arsyeja që, në privatizimin e bankave përparësi në blerjen e tyre patën dhe kanë investitorët strategjikë institucionalë, që ofrojnë blerjen e më shumë se një të tretës së aksioneve me të drejtë vote, deri në shumicën absolute të aksioneve të bankës. Si mënyra më e mirë e privatizimit u gjykua ajo me tender. Kjo mënyrë, parashikon ofrimin e çmimeve për blerjet nga të paktën tre investitorë të klasifikuar si të përshtatshëm për të blerë bankën.

Fillimisht, privatizimi përfshiu Bankën Kombëtare Tregtare, proces që tashmë ka përfunduar. Blerës të saj janë një investitor shtetëror turk (pas marrjes në zotërim nga Shteti Turk të KENT Bankut) me 60 për qind të aksioneve; si dhe dy institucione financiare ndërkombëtare BERZH (20 për qind minus një aksion) dhe Koorporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) 20 për qind minus një aksion. Privatizimi i sektorit bankar në rradhë të parë, kërkon që shteti të heqë dorë nga qeverisja e drejtpërdrejtë e institucioneve bankare dhe të marrë përsipër rolin që i takon dhe atë që i takon si rregullator dhe si mbikëqyrës i bankave. Eksperiencat në vendet e tjera, sugjerojnë se kalimi i bankave në pronësi private është mënyra e vetme që siguron një strukturë të duhur drejtimi (domethënë, që i lejon bankierët të marrin vendimet lidhur me shpërndarjen e kredive në mënyrë të pavarur) dhe operim efektiv në treg. Kjo përbën edhe çelësin për të kuptuar rolin e bankave gjatë periudhës së tranzicionit. Pronësia private mbi kapitalin

siguron sistemin e duhur të monitorimit të rrezikut dhe të shpërblimit, që janë bazat e drejtimit të bizneseve në ekonominë e tregut.

### **3.2.2. Privatizimi i Bankës së Kursimeve**

Autoritetet shqiptare janë shprehur pro privatizimit të Bankës së Kursimeve dhe madje ky proces ka filluar prej vitesh. Sipas parashikimeve të fundit mendohet që ky proces të përfundojë në mesin e vitit të ardhshëm.

Në mbështetje të këtij procesi, janë miratuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me miratimin e programit dhe të strategjisë së privatizimit të bankës, me formulën e privatizimit, rikapitalizimin e bankës dhe mbulimin e humbjeve nëpërmjet emetimit të bonove të thesarit, dhe është miratuar vendimi për procedurat e privatizimit të Bankës së Kursimeve. Vlen të përmendet që, për herë të parë gjatë 10 viteve të fundit, Banka e Kursimeve rezultoi me fitim në vitin 1999 dhe në vijim ka rritur fitimin, gjë që krijon një bazë të shëndoshë për perspektivën e bankës në të ardhmen. Po kështu, rikapitalizimi i bankës para përfundimit të procesit të privatizimit të saj (në dallim nga Banka Kombëtare Tregtare që u rikapitalizua në momentin e privatizimit) krijon një epërsi për bankën dhe e bën atë më atraktive për blerësit e huaj. Privatizimi i Bankës së Kursimeve, që parashikohet nëpërmjet investitorëve strategjikë, synon të rrisë eficiencën dhe fitimin e bankës, të rrisë konkurrencën në sistemin bankar, të sjellë teknologji dhe shërbime të reja, të rrisë nivelin e shërbimit dhe të ofrojë për klientët e bankës produkte të reja sipas praktikave ndërkombëtare të bankingut modern, të cilat me siguri do të rritin reputacionin e bankës dhe besimin e klientëve ndaj saj.

### **3.3 SISTEMI BANKAR SHQIPTAR DHE ZHVILLIMET E TIJ TË MËTEJSHME**

Zhvillimet e këtij viti na tregojnë për atë progres të arritur në veprimtarinë e sistemit bankar shqiptar, rrjedhojë kjo e reformave të kryera dhe e vëmendjes së veçantë nga autoritetet përkatëse. Kjo shihet si në arritjen e nje gjendjeje të shëndoshë financiare të bankave, në zgjerimin e aktivitetit kreditues të tyre, në zgjerimin e vëllimit të depozitave, të shtrirjes gjeografike ashtu dhe në ofrimin e shërbimeve të reja bankare .

Megjithëse me ritme të ngadalta, sot është arritur që krahas likuidimit të Bankës Tregtare Agrare (BTA) dhe privatizimit të

Bankës Kombëtare Tregtare, të krijohen dhe kushtet e duhura për privatizimin e Bankës së Kursimeve, si banka e fundit me kapital shtetëror. Krahas këtij procesi, në dy-tre vitet e fundit është rritur ndjeshëm dhe numri i bankave private, që operojnë në vendin tonë. Sot ky numër ka arritur në 10 dhe një bankë tjetër pritet të fillojë së shpejti nga aktiviteti.

Struktura e sistemit bankar për nga pronësia e kapitalit mund të klasifikohet në tre grupe :

- 1 bankë me kapital shtetëror (G1);
- 2 banka me kapital të përbashkët (G2);
- 10 banka apo degë bankash me kapital privat (G3).

Ndryshimi i strukturës së sistemit bankar ka ndikuar në përmirësimin e raporteve në favor të bankave të grupit të tretë. Ndryshime në sistemin bankar kanë ndodhur jo vetëm në rritjen në numër të bankave private, por edhe në shtrirjen gjeografike të tyre.

Kështu : Banka Tirana vepron edhe me 4 degë banke, Durrës, Fier, Gjirokastrë dhe Korçë; Banka Fead vepron edhe me 4 degë banke, Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan; Banka Italo-Shqiptare vepron edhe me 2 agjenci bankare në Tiranë dhe Durrës; Banka Kombëtare Greke ka hapur 3 agjenci bankare, Tiranë, Durrës dhe Elbasan; Banka Kombëtare Tregtare vepron me 10 degë banke, ndërsa Banka e Kursimeve ka në varësi të saj 37 degë dhe rreth 70 agjenci të shtrira në të gjithë vendin. Siç shihet, janë qytetet kryesore që kanë rritur interesimin e bankave private për shtrirjen e aktivitetit të tyre. Disa të dhëna për secilën bankë në 30.09.2001 jepen në tabelën e mëposhtme.

**Tabelë 3. Sistemi bankar shqiptar.  
(30.09.2001)**

Nr	Bankat	Numri i degëve	Pjesa që zë në tregun e depozitave (%)	Pjesa që zë në tregun e kredive (%)
----	--------	----------------	--	-------------------------------------

<b>I</b>	<b>Bankat me kapital shtetëror</b>		<b>64.7</b>	<b>4.5<sup>2</sup></b>
1	Banka e Kursimeve	37	64.7	4.5
<b>II</b>	<b>Bankat me kapital të përbashkët</b>		<b>4.8</b>	<b>33.6</b>
2	Banka Italo-Shqiptare	2	4.5	33.2
3.	Banka Islamike Arabo-Shqiptare	1	0.3	0.4
<b>III</b>	<b>Bankat me kapital privat</b>		<b>30.6</b>	<b>61.9</b>
4	Banka Kombëtare Tregtare	10	10.2	0.1
5	Banka Dardania		0.2	0.7
6	Banka Tirana	4	5.2	14.6
7	Dega e Bankës Kombëtare Greke	3		2.5
8	Banka Tregtare Ndërkombëtare			0.4
9	Dega e Bankës Alfa	3		2.9
10	Banka Amerikane e Shqipërisë	1		6.5
11	Banka Fefad	5		2.1
12	Dega e Bankës së Parë të Investimeve			0.1
13	Banka Tregtare e Greqisë			0.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithëse Banka e Kursimeve ende zotëron pjesën më të madhe të tregut të depozitave, fakt është se po bëjnë progres në këtë drejtim të gjitha bankat private. Këto të fundit po tërheqin me ritme të shpejta depozitat në valutë e në lekë. Këtë po e arrijnë si nëpërmjet ofrimit të një sistemi pagesash bashkëkohor për klientët (gjë që ka çuar në rritjen e depozitave në të parë), ashtu edhe në shtimin e depozitave me afat të vendosura nga kursimtarët. Tendencën në rënie të pozitave monopol të Bankës së Kursimeve e shohim po të krahasojmë ecurinë e peshës specifike të bilancit të secilit grup ndaj totalit të sistemit bankar.

**Tabelë 4. Peshë e totalit të bilancit të çdo grupi ndaj sistemit bankar<sup>27</sup>.**

Grup	Totali i bilancit 31.12.98	Në %	Totali i bilancit 31.12.99	Në %	Totali i bilancit 31.12.00	Në %	Totali i bilancit 30.09.01	Në %
I	176.4	85.6	205.4	81.4	175.5	64.8	181.5	60.3
II	10.4	5.1	14.7	5.8	16.8	6.2	18.0	6.0

<sup>27</sup> Të dhënat në fund të vitit 2000 në grupin e parë nuk përfshijnë totalin e bilancit të BKT, e cila tashmë i përket grupit të tretë.

III	19.2	9.3	32.4	12.8	78.6	29.0	101.7	33.7
	206.0	100.0	252.5	100.0	270.9	100.0	301.2	100.0

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Totali i bilancit të Bankës së Kursimeve ndaj atij të sistemit bankar, në fund të vitit 1998, zinte 85,65 për qind, në fund të vitit 1999, 81,4 për qind, në fund të vitit 2000 zinte 64,8 për qind dhe në fund të nëntëmuorit të këtij viti, 60,3 për qind.

Në kushtet kur bankat me kapital shtetëror u përjashtuan nga e drejta për përdorimin e kufirit të kreditit, kreditimi i ekonomisë megjithë mangësitë që vihen re, është kanalizuar nëpërmjet bankave private. Tashmë ato kanë formuar portofolin e tyre të kredive, i cili u rrit hapësirën e kreditimit afatshkurtër duke xhiruar të njëjtat fonde. Heqja, në fund të vitit 2000, nga ana e Bankës së Shqipërisë e kufirit të kreditit dhe mbështetja vetëm në treguesit e mbikëqyrjes për këtë veprimtari, krijon premisa më të mëdha për bankat për të rritur volumin e kredive për ekonominë.

Sistemi i pagesave është një nga sfidat që duhet përballuar në rrugën e reformimit të sistemit bankar në kuadrin e masave institucionale. Ky element, megjithë ndryshimet pozitive që i janë bërë, përbën aktualisht një nga pikat më të dobëta të sistemit bankar dhe një nga sfidat më të vështira në të ardhmen.

Sistemi i pagesave përfshin mekanizmin e transferimit të fondeve si midis klientëve ashtu edhe midis vetë institucioneve bankare, prandaj aktualisht po punohet në dy drejtime:

- a) projekti për përmirësimin e sistemit ndërbankar të pagesave nëpërmjet implementimit të RTGS (sistemi i pagesave në kohë reale), që është në rrugën e zbatimit. Ky projekt konsiderohet si një objektiv afatshkurtër i Bankës së Shqipërisë;
- b) përmirësimi i sistemit të kleringut të zakonshëm. Implementimi i këtyre sistemeve do t'u ofrojë bankave dhe klientëve të tyre shpejtësi dhe nivel të lartë shërbimi, fleksibilitet dhe standardizim, çka bën të mundur rritjen e efektivitetit të sistemit bankar.

#### **4. TREGU BANKAR**

##### **4.1 KARAKTERISTIKAT E TREGUT BANKAR**

Konkurrenca, si një tipar kryesor i zhvillimit po bëhet gjithnjë e më shumë e pranishme në tregun bankar. Karakteristikë kryesore e tregut bankar shqiptar është tendenca e uljes së pozitës monopol të Bankës së Kursimeve ( edhe pse jo me ritmet e duhura) dhe e rritjes së bankave të tjera dhe veçanërisht të bankave private. Kjo i hap rrugën gjithnjë e më shumë veprimit të forcave të tregut për përcaktimin e çmimit të huamarrjes e të huadhënies në monedhë kombëtare. Kjo tendencë është si rrjedhim jo vetëm i zgjerimit të veprimtarisë të bankave private, por edhe i politikës që ndjek Banka e Shqipërisë, e cila nëpërmjet përdorimit gjithnjë e më shumë të instrumenteve indirekte, i lë hapësirë ndikimit të faktorëve të tregut.

Tashmë mund të thuhet se në tregun bankar po rritin pjesën për treg bankat private. Kjo shihet në zgjerimin e veprimtarisë bankare në tregun e depozitave apo të parasë të bankave të grupit të dytë e të tretë. Mjafton të përmendim se pesha specifike e zërit të pasivit "Veprime me klientë", që përfaqëson veprimet në llogari dhe në depozita, ka evoluar me prije në rritje për bankat private dhe me kapital të përbashkët. Të dhënat tregojnë për një rritje të ndjeshme të aktivitetit të bankave private, pesha e të cilave nga 6,2 për qind në vitin 1999, ka arritur në 30,7 për qind në shtator të vitit 2001.

**Tabelë 5. Pesha e zërit "Veprime me klientët" në sistemin bankar.** (në %)

G1			G2			G3		
31.12.99	31.12.00	30.09.01	31.12.99	31.12.00	30.09.01	31.12.99	31.12.00 <sup>28</sup>	30.09.01 <sup>29</sup>
89.6	69.1	64.5	4.2	4.6	4.8	6.2	26.3	30.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritjen e rolit të bankave private në treg e përforcon edhe hyrja në të e Bankës Kombëtare Tregtare, që tashmë prej një viti zhvillon aktivitetin e saj në 10 qytete kryesore të vendit.

Shtirja e veprimtarisë bankare ka bërë që bankat të rrisin nivelin e shërbimit, si një ndër rrugët për të tërhequr klientët e rinj. Për të realizuar këtë, bankat po investojnë në teknikë dhe në teknologji, duke futur sisteme dhe programe bashkëkohore. Edhe vetë Banka

<sup>28</sup> Treguesi i grupit III është më i madh pasi për efekt krahasimi me vitin 1999 nuk është përfshirë pesha e Bankës Kombëtare Tregtare, e cila është përfshirë në grupin I.

<sup>29</sup> Treguesi i grupit III është më i madh, pasi për efekt krahasimi me vitin 1999 nuk është përfshirë pesha e Bankës Kombëtare Tregtare, e cila është përfshirë në grupin I.

e Kursimeve, duke e ndjerë konkurrencën e bankave të tjera ka ndërmarrë investime në këtë drejtim.

Është kjo konkurrencë, që po u dikton bankave të hartojnë strategjitë e tyre për të qenë më aktive në zotërimin e tregut bankar.

## **4.2 TREGU I DEPOZITAVE**

Banka, si një biznes i veçantë, mbështetet në përdorimin e burimeve monetare të të tretëve ku depozitat zënë peshën më të lartë në totalin e pasivit. Interesi i bankave tregtare për të tërhequr kursimet përputhet dhe me politikën monetare të Bankës së Shqipërisë për të mbajtur nën kontroll ofertën e parasë. Kjo e fundit monitoron agregatët monetarë duke synuar minimizimin e presioneve inflacioniste të këtyre treguesve. Karakteristikë e depozitave tek ne është se ato kanë ardhur gjithmonë në rritje dhe me ritëm të kënaqshëm. Ky ritëm ra vetëm gjatë muajve të lulëzimit të skemave piramidale (tetor- dhjetor 1996). Raporti i depozitave gjithsej ndaj totalit të PBB-së, si një tregues që shpreh shkallën e thellësisë së ndërmjetësimit financiar, kap shifrën 43 për qind për vitin 2000 dhe afro 44 për qind për vitin në vazhdim. Ky tregues është poshtë nivelit të Eurozonës që është 78 për qind, por i krahasueshëm me vendet e tjera të tranzicionit. Në nivele të kënaqshme është edhe treguesi i depozitave me afat ndaj totalit të PBB-së, që për vitet 2000 dhe 2001 është përkatësisht 37 për qind dhe 40 për qind. Ky tregues është më sinjifikativ, pasi shpreh shkallën e grumbullimit të kursimeve të qytetarëve dhe të besimit të tyre ndaj institucioneve bankare.

Deri në vitin 1996, tregu i depozitave i përkiste kryesisht tre bankave me kapital shtetëror. Karakteristikë e kësaj periudhe ishte segmentimi i plotë i tregut. Banka e Kursimeve zotëronte tregun e depozitave të publikut, ku rreth 85 për qind e tyre i përkiste kësaj banke. Banka Kombëtare Tregtare zotëronte rreth 70 për qind të depozitave të ndërmarrjeve dhe rreth 90 për qind të totalit të kredisë së akorduar atyre, ndërsa Banka Tregtare Agrare nëpërmjet agjencive të saj operonte kryesisht në zonën rurale.

Gjatë 3-4 viteve të fundit, si rrjedhojë e konkurrencës së bankave të grupeve II dhe III, tendencat, struktura e depozitave dhe preferencat e klientëve dhe, para së gjithash të individëve, kanë pësuar ndryshime. Gjatë kësaj periudhe, pjesa e tregut të depozitave nga bankat me kapital shtetëror ka shënuar vazhdimisht rënie. Ndërsa, në vitin 1999, ky grup zotëronte 84 për

qind të këtij tregu, në shtator të vitit 2001 ky tregues ka zbritur në 64 për qind. Ndërkohë, janë bankat e tjera private që po zgjerojnë pjesëmarrjen në këtë treg . E rëndësishme është se bankat private janë më aktive në tregun e depozitave në valutë, megjithëse kohët e fundit ato po tregojnë interes edhe në tregun e depozitave në lekë. Vetëm për nëntëmujorin e këtij viti depozitat gjithsej janë rritur 28 miliardë lekë ose 12 për qind. Ritmet më të larta janë për depozitat në valutë, rrjedhojë kjo edhe e uljes së vazhdueshme të normave të interesit të depozitave në lekë.

**Tabelë 6. Treguesi i depozitave të sistemit bankar.**

(në miliardë lekë)

Sistemi bankar		Grupi I		Grupi II		Grupi III	
31.12.00	30.09.01	31.12.00	30.09.01	31.12.00	30.09.01	31.12.00	30.09.01
229.8	256.5	158.8	165.6	10.5	12.3	60.5	78.6

Burimi:Banka e Shqipërisë.

### 4.3 TREGU I KREDITIT

Kreditimi i ekonomisë gjatë 10 viteve të fundit është kushtëzuar nga mjaft faktorë politikë dhe ekonomikë si dhe fenomene të tjera, që kanë karakterizuar tranzicionin shqiptar. E rëndësishme është se pesha e sektorit privat në kreditim ka ardhur gjithnjë në rritje. Në totalin e stokut të kredive për ekonominë, sektori privat sot zë 94.5 për qind, nga 63 për qind që zinte në vitin 1993.Por, nga ana tjetër, niveli i kreditimit gjatë këtyre viteve ka qenë i ulët. Në Shqipëri, niveli i kreditimit është vetëm 5.4 për qind e PBB-së, kur në vendet e tjera të Europës Lindore ky tregues është në kufijtë 35-40 për qind, ndërsa në vendet e Europës Perëndimore, si ekonomi që financohen fuqishëm nga sistemi bankar (në dallim nga USA që në pjesën më të madhe financohet nga tregjet financiare) ai varion nga 70 për qind deri 100 për qind të PBB-së.

Megjithëse Banka e Shqipërisë në vitet 1993-1999 përcaktonte kufi krediti për bankat, këto të fundit, në përgjithësi, nuk e kanë përdorur atë, gjë që tregon se ky instrument nuk ka qenë pengues në kreditimin e ekonomisë.

**Tabelë 7. Kufiri i kreditit dhe realizimi i tij.**

(në milionë lekë)

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Kufiri	7.4	5.4	2.9	3.1	2.3	8	8
Realizimi i	2.9	3.5	1.75	2.9	1.7	2	2.2

kufirit							
Realizimi në %	39	64	60	95	75	25	27.5

Ky mosrealizim shpjegohet jo me mungesën e nevojës së bizneseve për kredi, por me shkaqe të tjera. Tregu i kreditit, deri në fund të vitit 1996, zotërohej pothuajse tërësisht nga tre bankat me kapital shtetëror, të cilat krahas fondeve të tyre administronin edhe fondet e pjesës më të madhe të projekteve financuese të donatorëve. Si rrjedhojë e një përzgjedhjeje të dobët të klientëve ardhur kjo nga mjaft faktorë, portofoli i këtyre bankave u përkeqësua me shpejtësi. Nga 14 për qind që zinte kredia e pakthyer në afat në stokun e kredisë në vitin 1993, ky tregues u dyfishua një vit më vonë dhe arriti në rreth 60 për qind në vitin 1997. Ky tregues negativ i përkeqësuar më tej nga situata e rëndë financiare, që u krijua nga falimentimi i skemave piramidale, vuri në rrezik ecurinë normale të sistemit bankar. Është kjo arsyeja që Banka e Shqipërisë pezulloi dhënien e kredive nga bankat, që kishin këtë tregues mbi standardin ndërkombëtar prej 20 për qind. Kështu, që të tri bankat me kapital shtetëror pezulluan kredidhënien dhe ju nënshtruan procesit të reformimit të thellë. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë synoi që nëpërmjet reduktimit të inflacionit të lartë që pati në fund të vitit 1997 (ky tregues rezultoi 42 për qind) të ndikonte në uljen e çmimit të kredisë në lekë për bankat private, që filluan të operonin në këtë periudhë. Megjithëse gjatë viteve 1998 dhe 1999 niveli i normave të interesave u ul ndjeshëm, kjo nuk u reflektua në uljen, në të njëjtën masë, të normave të interesit për kreditë. Marzhi i këtyre të fundit mbeti përsëri i lartë. Kreditë e akorduara nga bankat private kanë qenë kryesisht në valutë, por ato ishin në nivele mjaft të ulta duke mos kredituar siç duhet ekonominë. Minimizimi i rrezikut të kursit është arsyeja kryesore e kësaj karakteristike. Marzhi i lartë mes interesave për depozitat dhe interesave të kredisë në lekë e ka bërë huadhënien në lekë më të shtrenjtë.

Ndër arsyet kryesore për nivelin e ulët të kreditimit të ekonomisë mund të përmendim:

- ◆ Niveli i lartë i rrezikut të kreditit (rreziku i vendit dhe ai politik) në Shqipëri, i cili i frenon bankat të shtrihen në këtë aktivitet.
- ◆ Marrëdhëniet bankë-biznes janë ende marrëdhënie jopartneriteti. Bizneset shqiptare nuk punojnë me bankat dhe këto të fundit, duke mos patur një histori me to i konsiderojnë klientë të pasigurtë.
- ◆ Mosfunksionimi efikas i sistemit gjyqësor dhe përmbarues.

- ◆ Mungesa e shtrirjes së bankave që japin kredi në të gjithë territorin e vendit etj..

Gjithashtu, **bankat krahas ngurrimit për të kredituar kanë politika të caktuara në tregun e kreditit**. Kështu, ndërsa Banka Fead e ka ndërtuar politikën e saj në dhënie kredi, biznesit të vogël e të mesëm duke mos patur konkurrencë nga bankat e tjera, këto të fundit synojnë kryesisht në kreditimin e biznesit të madh. Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare gjatë vitit 2000 dhe këtij viti, shtimi i bizneseve serioze e të besueshme janë faktorët kryesorë që kanë bërë të mundur, që, gjatë kësaj periudhe, bankat të jenë më aktive në tregun e kreditit. Vetëm gjatë nëntëmujorit të këtij viti stoku i kredisë si sistem bankar u rrit 5.3 miliardë lekë, në një kohë që për gjithë vitin 1999 ky tregues ishte 2.2 miliardë lekë. Bankat kanë dhënë kredi të re gjatë këtij nëntëmujori 19.5 miliardë lekë. Megjithë këtë zhvillim pozitiv, **përsëri ruhet preferenca e dhënies së kredisë në valutë**.

Të dhënat e mëposhtme tregojnë prirjen e zgjerimit të tregut të kreditit gjatë këtij viti:

**Tabelë 8. Ecuria e kreditit për ekonominë**

(në milionë lekë)

	Dhjetor 1999	Dhjetor 2000	Shtator 2001
Stoku i kredisë	19,890	25,944	31,244
Kredi në lekë	10,612	13,129	11,200
Kredi në valutë	9,277	15,084	20,044
Pesha specifike e kredisë në valutë	47.0 %	53.5%	64.5 %

Nga të dhënat kuptohet se janë vetëm grupet II dhe III të bankave që akordojnë kredi, pasi Bankës së Kursimeve ky aktivitet i është pezulluar deri në privatizimin e saj. Nëse kredia e akorduar fillimisht ishte kryesisht afatshkurtër, **këtë vit është rritur dhe pesha specifike e kredisë afatmesme dhe afatgjatë**. Kredia afatmesme është dhënë në mbështetje të bizneseve në industrinë përpunuese, ndërsa nga ana tjetër vazhdojnë të akordohen kredi për tregtinë, për ndërtimin, për peshkimin etj..

Niveli i kreditimit të ekonomisë është edhe më i lartë po të kemi parasysh edhe veprimtarinë e disa projekteve të ndryshme, që operojnë me burimet e donatorëve (Fondacioni Besa, Fondi i Financimit Rural, Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillimin e Ndërmarrjeve etj.).

## 5. ZHVILLIME NË NDËRMJETËSIT E TJERË FINANCIARË

### 5.1 INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE

Institutet e sigurimeve. Jeta e kësaj industrie daton 10 vjet më parë, me krijimin e Institutit të Sigurimeve. Aktiviteti i këtyre instituteve bazohet në ligjin nr.8081, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit", datë 07.03.1996. Aktualisht, në vend ushtrojnë aktivitetin e tyre 4 shoqëri sigurimesh, INSIG, SIGAL, SIGMA dhe ATLANTIK sh.a. ku tre të fundit janë shoqëri private. Me privatizimin e të vetmes shoqëri sigurimesh INSIG, i gjithë tregu i sigurimeve bëhet privat dhe shteti i jep fund pjesëmarrjes në këtë treg.

**Fondet e pensioneve.** Në Shqipëri ekziston vetëm një institut për sigurimet shoqërore, "Institut i Sigurimeve Shoqërore", i krijuar me ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Veprimtaria e institucioneve të tjera private të pensioneve dhe e skemave private të fondeve të pensioneve, mbështetet në ligjin "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", nr.7943, datë 01.06.1995. Aktualisht, në vend prania e këtyre institucioneve është inekzistente. Mosekzistenca dhe mosfunksionimi i tyre lidhet me specifikën e funksionimit të tyre mbi parimin e investimeve në portofole të diversifikuara letrash me vlerë. Gjithashtu, negativisht ndikon moskrijimi ende i entit rregullator respektiv për këto institucione, aftësia e ulët pagueve e përfituesve dhe rreziku i lartë i investimit në këtë fushë. Ashtu si fondet e investimeve, funksionimi operacional i tyre kushtëzohet mjaft nga ekzistenca e një game të instrumenteve financiare të tregtueshme në Bursën e Tiranës dhe nga ekzistenca e një burse funksionale. Së fundi, legjislacioni ekzistues nuk i përcakton e nuk i jep statusin e duhur të investitorit institucional këtyre instituteve.

### 5.2 INSTITUCIONET FINANCIARE TË MIKROKREDITIT

Një zhvillim mjaft pozitiv, që vihet re vitet e fundit është dhe prania e institucioneve të mikrokreditit që përfaqësohen nga Shoqëritë e Kursim Kreditit (SHKK), të cilat në thelb janë kooperativa kredie që mobilizojnë kursimet e anëtarëve dhe u japin kredi vetëm atyre. Veprimtaria e këtyre institucioneve bazohet në ligjin "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Reciprok" dhe në ligjin "Për Shoqëritë e Kursim Kreditit". Domosdoshmëria e operimit të institucioneve të mikrokreditit lindi si pasojë e mosinteresit të bankave për të

akorduar mikrokredi për biznesin e vogël në qytet dhe për ekonomitë fermere në fshat. Një rol të rëndësishëm në mbështetjen e ngritjes dhe të konsolidimit të SHKK-ve po luajnë donatorë të ndryshëm nëpërmjet disa projekteve tashmë të njohura.

Sot në Shqipëri operojnë 81 SHKK, të cilat janë në fazën e konsolidimit të tyre. Ende pjesa e kursimeve të mobilizuara nga antarët e SHKK-ve është e ulët, por parë në këndvështrimin psikologjik ky proces duhet vlerësuar si mjaft pozitiv. Disa të dhëna për operimin e SHKK-ve jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Nr. SHKK-ve	Portofoli i kredive (USD)
1.	Fondi i Financimit Rural	51	1.011.736
2.	Lëvizja për zhvillimin e shkk	30	123.323
	<b>TOTALI</b>	81	1.135.059

Veprimtaria e SHKK-ve zhvillohet kryesisht në hapësirat e pambuluara nga sistemi bankar duke rritur kështu numrin e aktorëve në treg.

Konsolidimi dhe zgjerimi i operimit të SHKK-ve, jo vetëm do të rrisë peshën e tyre në treg, por krijon dhe premisat e organizimit të formave institucionale bankare. Një hap fillestar në këtë drejtim është krijimi i unioneve të para të tyre, që koordinojnë dhe administrojnë më mirë veprimtarinë e SHKK-ve. Për t'iu përgjigjur më mirë këtyre zhvillimeve, tashmë është përmirësuar baza ligjore e operimit të SHKK-ve dhe po krijohet kuadri i duhur rregullativ dhe mbikëqyrës i tyre. Banka e Shqipërisë, si autoritet mbikëqyrës, tashmë ka miratuar kuadrin rregullator dhe mbikëqyrës të SHKK-ve, duke synuar parandalimin dhe shmangien e fenomeneve negative në zhvillimet e ardhshme të tyre.

### 5.3 TREGU I KAPITALIT

Tashmë dihet se në vendet e zhvilluara tregu financiar dhe, para së gjithash, tregu i kapitalit siguron burimet kryesore të fondeve për operatorët ekonomikë.

Përpjekjet e bëra deri tani për zhvillimin e këtij tregu në Shqipëri kanë qenë kryesisht në formulimin e ligjeve përkatëse dhe në ndërtimin e institucioneve pjesëmarrëse në të. Zhvillimi i tregut të kapitaleve është i lidhur me shumë elemente të reformave

ekonomike dhe sidomos me reformat bankare, të institucioneve financiare jobankare si dhe me procesin e privatizimit të kompanive shtetërore. Pas miratimit të ligjit "Për letrat me vlerë" (1995) u krijua Bursa e Tiranës dhe Komisioni i Letrave me Vlerë si dy institucione të rëndësishme.

Megjithë krijimin e Bursës së Tiranës, ajo ende nuk luan rolin e një tregu kapitalesh. Në këtë bursë janë tregtuar dhe vazhdojnë të tregtohen vetëm bono thesari, si të vetmet instrumente të tregut të parasë. Dështimi i privatizimit masiv është një ndër shkaqet që Bursa e Tiranës nuk arriti të luante rolin e saj. Edhe pse funksionon Qendra e Regjistrimit të Aksioneve, transaksionet e shitblerjes shpesh janë regjistruar dhe janë jashtë kësaj qendre. Deri më sot, nuk ka asnjë aksion të listuar në Bursën e Tiranës dhe praktikisht në Shqipëri nuk ka treg të mirëfilltë zyrtar kapitali, duke shënuar të vetmin vend në Europë pa bursë kapitali apo tregtim zyrtar kapitalesh. Aktiviteti i tregtimit në Bursën e Tiranës për bonot e thesarit (deri në vitin 1999, sepse pas këtij viti në Bursën e Tiranës nuk është ekzekutuar asnjë transaksion) gjithnjë është karakterizuar nga një numër i kufizuar transaksionesh të ekzekutuara dhe volum i ulët tregtimi dhe ka funksionuar gjithnjë si një treg i pastër paraje (me përjashtim të vitit 1996).

#### Transaksionet në Bursën e Tiranës (në 000 lekë).

Instrumenti	VITI					
	1996 (2 Maj-)	1997	1998	1999	2000	2001
Bono thesari	3,305,000	6,325,000	4,959,000	75,000	0	0
Obligacione qeveritare	800,000	0	0	0	0	0
Bono privatizimi	0	0	0	0	0	0

Ecuria e mirë e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve strategjike është një premisë për të ardhmen, pasi ato rrisin numrin e instrumenteve të tregtueshme në bursë. Megjithatë, fillimisht operatorët parashikohen të jenë të kufizuar në numër duke patur parasysh këtu formulën e privatizimit të kompanive nga një numër i vogël zotëruesish aksionesh. **Aksionerët kryesorë fitues të ndërmarrjeve të privatizuara janë kompani të huaja të mirënjohura, të cilat parashikojnë të rrisin investimet e tyre në Shqipëri.** Mënyra e privatizimit me ofertë publike të ndërmarrjeve strategjike deri tani nuk është zbatuar.

Vënia në funksionim e Bursës tashmë konsiderohet si një domosdoshmeri e zhvillimit ekonomik të vendit. Në funksion të këtij qëllimi po synohet rritja e pavarësisë së saj .**Shkëputja e Bursës së Tiranës nga Banka e Shqipërisë, ku ajo konsiderohet si departament dhe transformimi në ent të pavarur, është hapi i parë dhe kryesor që duhet realizuar sa më shpejt.** Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë mbi shkëputjen e Bursës së Tiranës dhe përgatitja e draftit të ligjit përkatës në të cilin sanksionohet pavarësia e bursës janë sinjale të para të zhvillimit të tregut të kapitaleve në të ardhmen. **Rritja e numrit të ndërmjetësve dhe listimi i kompanive të para tashmë nuk duken larg.**

## 6. KONKLUZIONE

- Sistemi financiar ka pësuar ndryshime të konsiderueshme gjatë kësaj dekade nga pikëpamja ligjore, kuadri rregullativ, zgjerimi i rrjetit dhe niveli i shërbimeve duke iu përgjigjur më mirë nevojave dhe duke reflektuar gjendjen e ekonomisë reale.
- Komponenti më dinamik i këtij sistemi ka qenë sistemi bankar i cili ka pësuar një sërë zhvillimesh në drejtim të:
  - a) rrjetit dhe shtrirjes së tij graduale në të gjithë territorin e vendit;
  - b) zgjerimit të gamës të produkteve të ofruara dhe përmirësimit cilësor të nivelit të shërbimit në qytetet kryesore të vendit;
  - c) uljes së vazhdueshme të shkallës së koncentrimin edhe pse Banka e Kursimeve vazhdon të ruajë pozicionin dominues prej 60 për qind të totalit të aktiveve, që përbën edhe pikën më të dobët lidhur me perspektivën e sistemit bankar;
  - d) përmirësimit të ndjeshëm të treguesit të rentabilitetit dhe atij të mjaftueshmërisë së kapitalit.
- Megjithëse krediti për ekonominë është drejtuar pothuajse plotësisht në sektorin privat të saj, niveli i kreditimit nga sektori bankar është ende i ulët duke zënë 5,4 për qind të PBB, tregues ky mjaft larg atij të vendeve të tjera europiane.
- Sistemi i pagesave përbën një nga pikat më të dobëta të sistemit bankar. Implementimi i sistemit RTGS dhe përmirësimi i kleringut të zakonshëm, përbëjnë sfidat e periudhës afatshkurtër dhe afatmesme.

- Institucionet e sigurimit janë shtuar në numër dhe ka filluar të ndihet konkurrenca në treg, por edhe ky sektor karakterizohet nga koncentrimi.
- Koncentrimi shfaqet në dy drejtime:
  - a) pesha që zë kompania shtetërore INSIG është ende e madhe, me mbi 90 për qind të totalit të aktiveve;
  - b) në strukturën e të ardhurave mbisundojnë primet motorike dhe të pasurisë, të cilat kapin 95 për qind të tyre, ndërsa sigurimet e jetës zënë vetëm 5 për qind të totalit.
- Stadi aktual i zhvillimit, e bën mëse të domosdoshëm vazhdimin e njëkohshëm të reformave në të tre komponentët përbërës të sistemit financiar dhe, para së gjithash, në tregun e kapitalit, duke përbërë dhe sfidën e së ardhmes për sistemin financiar.

## REFERENCAT

Michel de Mourgues " La monnaie e les instruments financiers"

Chorng-Huey Wong " La reforme des instruments de politique monetaire", *Finances e Developpement Mars 1992*

Marie Lavigne " L'Europe de l'est du plan au Marche"  
dans les ancienne economies planifices" *Finances e  
developpement Mars 1994*

The World Bank *Albania and World Bank; Building the Future*,  
(July, 1994)

Banka e Shqipërisë *Buletini Nr. 1, 2, 3, 4 ; 1999; 2000*  
Banka e Shqipërisë *Raporti vjetor 1997; 1998;1999, 2000*

*Deklarata e Politikës monetare të gjashtëmujorit të I-rë 2001*

Banka e Shqipërisë *Buletini mujor statistikor, Korrik 2001.*

Banka e Kursimeve *Buletini vjetor 1997, 1998, 1999*

Orfea Dhuci *Ekonomia dhe Tranzicioni, 1999*

Qamil Talka *Ekonomia dhe Tranzicioni, 2000*